

V E N D I M

Nr.616, datë 10.10.1998

PËR KRIJIMIN E LEHTËSIRAVE TË VEPRIMTARISË SË AVIONËVE DHE ANIJEVE USHTARAKE TË ORGANIZATËS SË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR (NATO) NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 7 të dekretit nr.4650, datë 9.3.1970 “Për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.8374, datë 15.7.1998 “Për përdorimin e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.7816, datë 20.4.1994 “Për ratifikimin e dokumentit kuadër të partneritetit për paqe” dhe të rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nr.1199 për Kosovën, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të hapësirës ajrore dhe aeroporteve të Republikës së Shqipërisë për fluturimin e avionëve dhe helikopterëve ushtarakë të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior deri më datë 31.12.1998 për kryerjen e veprimeve të tyre në ndihmë të zgjidhjes së krizës së Kosovës dhe për rritjen e sigurisë në rajon.

2. Miratimin e hyrjes e lundrimit në ujërat territoriale e të brendshme dhe përdorimit të porteve detare të Republikës së Shqipërisë nga ana e anijeve ushtarake të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior deri më datë 31.12.1998 për kryerjen e veprimtarisë së tyre në ndihmë të misionit të sigurisë në rajon.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Punëve Publike dhe e Transportit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano